

Agjencia miratoi Udhëzuesin për prezantim mediatik gjatë referendumit

Shkup, 17.08.2018. – Në mbledhjen e sotme të 34-të, Këshilli i Agjencisë e miratoi Udhëzuesin për prezantim mediatik gjatë referendumit.

Në këtë dokument janë të shënuara rregullat për radiodifuzerët komercial dhe për shërbimin publik të radiodifuzioni, në lidhje me mënyrën e raportimit dhe prezantimit mediatik në emisionet e informimit ditor, programet e vecanta informuese dhe programet e tjera, rregullat për shpalljen e rezultateve të hulumtimit të mendimit publik, propagandës së paguar publike, informimit gjatë ditës së heshtjes së referendumit.

Udhëzimi për prezantim mediatik gjatë referendumit mund të merret në këtë link